



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1620 prot

Roskovec , më 27.03 .2020

VENDIM

NR 17 ,DATË 27.03 .2020

“PËR

**DHËNIE NDIHMA USHQIMORE PËR FAMILJET NË NEVOJE DHE MIRATIMIN E
DESTINACIONIT TË PËRDORIMIT PËR SUBVENCIONIN PËR UJESJELLËS-
KANALIZIME ROSKOVEC SH.A PËR VITIN 2020 (603) ”**

Në mbështetje të ligjit 139/2015 “Per veteqeverisjen vendore“neni 9 pika 1.4 gërma a,neni 40 pika 1,neni 54 gërma dh, Ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetore në RSH”, të ligjit 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjen vendore“ , të udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” , të VKM nr. 243 , datë 24.03.2020 "Për shpalljen e gjëndjes së fatkeqësisë natyrore" pika 6.1/2.b e tij, të ligjit nr.9901 datë 14.4.2008 ”Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të relacionit të sjell nga Shtabi i Emergjencave Civile të Bashkisë si dhe relacionit nga Ujesjelles-Kanalizimeve sha Roskovec , në kushtet e epidemisë së shkaktuar nga COVID-19 ;Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

- I. Të miratohet fondi prej 600,000 lekë për dhënien e ndihma ushqimore dhe detergjent për familjet e varfëra në nevojë që nuk përfitojnë nga vendimi nr.2 , datë 24.03.2020 të Komisionit Qëndror për Ofrimin e Asistencës, të evidentuara dhe të miratuara nga komisioni i ngritur për këtë qëllim, sipas kriterëve të cilat janë të përcaktuara në relacionin e bashkëlidhur.

Fondi të përballohet në masën:

- 1) 500,000 lekë nga zëri "Ndhimat për jetimet+invaliditet dhe familjet e varfëra" të miratuara në buxhetin e bashkis viti 2020.



2) Diferenca nga vlera e ushqimeve për kopështin me drekë Roskovec , për aq kohë sa kopështi përkatës do të jetë i mbyllur nga situata emergjente COVID-19 , e përlogaritur 143 lekë dietë ushqimore për fëmijë ne ditë me numër të përgjithshëm 75 fëmijë që rezulton në muajin shkurt 2020 , bazuar kjo në kriteret e vendosura si më sipër .

II. Miratimin të destinacionit të përdorimit të subvencionit i miratuar në buxhetin për vitin 2020 (ne llog.603) në vlerën 2,000,000 lekë për paga te pashlyera ndaj punonjesve dhe për “Blerje klori” , si më poshtë:

- Për pagat e punonjësve 1,881,320 lekë
- Blerje klori 118,680 lekë

Shuma: 2,000,000 lekë

III. Ngarkohet Drejtoria Ekonomike e bashkisë dhe Ndërmarja e Ujësjellës-Kanalizimeve sh.a. Roskovec për zbatimin e këtij vendimi.

IV. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R

Kadri Hyska

